



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË
GJIMNAZI "SADI NURI" NDROQ

Nr:38/ Prot

Ndroq me:27/04/2015

NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND TË LIRE PUNE

Drejtoria e gjimnazit "Sadi Nuri" Ndroq, në zbatim të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të "VKM Nr 36 " datë 03.02.2010 "Për riorganizimin e Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore", si dhe të udhëzimit nr.58, date 12/11/2013 "Për procedurat e emerimit dhe shkarkimit nga puna të nendrejtorit të institucionit arsimor publik , të arsimit parauniversitar", shpall konkursin për vend të lire pune në pozicionin nendrejtor i institucionit arsimor publik në ;

1.Gjimnazin "Sadi Nuri" Ndroq, Tirane

KERKESA TË VECANTA PËR KANDIDATET;

Kandidati/ja për nendrejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet:

- a) Të ketë diplome të nivelit të dytë në fushën e edukimit ose diplome të njehshme me të sipas përcaktimeve të ligjit nr.9741 , date 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në republikën e Shqipërisë , të ndryshuar (fotokopje të noterizuara të diplomave dhe të listave të notave të shkollës së lartë).
- b) Të ketë të pakten kategorinë "mësues i kualifikuar" dhe në provimin e kualifikimit të jetë vlerësuar "shumë mirë" ose "mirë"(fotokopje të noterizuara të dëshmisë së kualifikimit).
- c) Të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij (nese nuk ka , e deklaron me shkrim që nuk ka).

DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT DHE AFATI I DOREZIMIT

Kandidati/ja per nendrejtor i institucionit publik te arsimit parauniversitar duhet:

- a) CV dhe kopje të dëshmvive apo dokumente që vërtetojnë pohimet në CV (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr.1, bashkëlidhur ketij udhëzimi).
- b) Tabelën e plotësuar me të dhënat për aplikuesin (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr. 2, bashkëlidhur ketij udhëzimi).
- c) Dëshminë e penalitetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit.
- d) Deklaraten personale që verteton se nendrejtori nuk ka lidhje familjare me drejtorin e institucionit (bashkeshort?te ,prind ,vella?moter ,femije ne moshe madhore,etj.)
- e) Dy rekomandime nga mesues ose drejtore te institucioneve arsimore ose titullare te njesive arsimore vendore qe kane punuar me aplikantin gjate viteve te fundit (Sipas modelit ne shtojcen nr.3,bashkelidhur ketij udhezimi).

Dorëzimi i dokumentacionit të aplikimit për konkurim , do të bëhet pranë drejtorisë së Gjimnazit "Sadi Nuri"Ndreq , me adresë Rruga Nacionale Tirane-Ndreq Km 17, cdo ditë nga ora 08:00 – 14:00.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të aplikimit për konkurim , do të jetë data 06.05.2015 ora 14.00.

Dokumentacioni për aplikim dorëzohet në drejtorinë e Gjimnazit "Sadi Nuri"Ndreq me procesverbal dorëzimi.

DREJTOR

Enkelelda Brahja





REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË
GJIMNAZI "SADI NURI" NDROQ

Nr:37/ Prot

Ndroq me;27/04/2015

NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND TË LIRE PUNE

Gjimnazi "Sadi Nuri" Ndroq, në zbatim të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014 "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar", shpall njoftimin e kërkesave për konkurim, për vendin e lirë të punës në pozicionin **Mësues Fizike** në :

1. Gjimnazi "Sadi Nuri" Ndroq .Të gjithë mësuesit e këtij profili (profili Fizike), të interesuar për këtë pozicion pune (**Mësues Fizike**), duhet të paraqesin pranë drejtorisë së Gjimnazit "Sadi Nuri" Ndroq dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare, sipas përcaktimeve të nenit 57 të Ligjit Nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë).
- b) CV dhe kopje të dëshmimeve apo dokumente që vërtetojnë pohimet në CV (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr.1, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).
- c) Tabelën e të dhënave për aplikant (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr. 2, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).
- d) Raportin mjeko - ligjor.
- e) Dëshminë e masave disiplinore në fuqi në ngarkim të tij. (Nëse nuk ka e deklaron me shkrim që nuk ka).
- f) Dëshminë e penalitetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit.

Dorëzimi i dokumentacionit të aplikimit për konkurim , do të bëhet pranë drejtorisë së Gjimnazit “Sadi Nuri” Ndroq , me adresë Rruga Nacionale Tirane-Ndroq Km 17, cdo ditë nga ora 08:00 – 14:00.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të aplikimit për konkurim , do të jetë data 06.05.2015 ora 14.00.

Dokumentacioni për aplikim dorëzohet në drejtorinë e Gjimnazit “Sadi Nuri” Ndroq me procesverbal dorëzimi.

DREJTOR
Enkeleda Brahja

